

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E HËNË 17 TETOR 2022

Nëse kishim si synim t'i jepnim shijen e parë, reale, zonjës ambasadore, se si janë gjërat në këtë vend, sapo e bëmë. Ndonjëherë është mirë t'i themi gjërat siç janë. Mund ta shikojmë me sytë tanë, të opozitës, mund ta shikoni me sytë tuaj, të maxhorancës, kurrë nuk do të biem dakord, por ka një palë sy, që u besojmë dhe u përgjërohemi, të cilët shikojnë me realizëm, janë sytë e shqiptarëve. Mjafton të shikojmë faktin që shqiptarët kanë ikur masivisht, madje viti 2021 shënon dhe rritjen e kërkesave për azili, për të kuptuar se cila është situata në këtë vend.

Ne nuk mund t'u kërkojmë europianëve të na i zgjidhin problemet, ato duhet t'i zgjidhim vetë, sepse janë çështjet tona, kështu tha edhe ambasadorja, që duhet t'i zgjidhim ne. Për të zgjidhur këto çështje ne duhet të tejkalojmë veten, për aq kohë dhe për aq sa u përkasin çështjeve të integritimit europian. Për ta bërë këtë, këtu flas për opozitën, ne i kemi bërë aktet tona: fjalë të mira për vetingun, por ishte zgjatja e mandatit që u votua nga ne; fjalë deri diku për reformën zgjedhore, që ka vonesat e veta, por ishte çështje e kërkuar nga ne; fjalë të mira për zgjedhjet e vitit të kaluar ose për marrëveshjen e 5 qershorit, ku ishte dora jonë e shtrirë.

Në fakt, historia vazhdon siç të gjithë e dimë, marrëveshja politike ra, ju ndryshuat Kushtetutën dhe u vodhën zgjedhjet; ky është fakt. E pra, ky është thelbi i çfarëdolloj përplasjeje që ka në politikë. Ajo çfarë duhet të bëjmë ne, duke dalë nga vetja jonë, është që, po, të gjitha, siç thatë ju zonja Ministre, shinat se ku duhet të ecim i keni përcaktuar, por ritmi me të cilin duhet të ecim është i rëndësishëm, sepse nuk është e rëndësishme të marrësh pjesë, e rëndësishme është të fitosh, dhe shqiptarët duhet të fitojnë dhe të shkojnë një orë e më parë në Europë. Për ta bërë këtë ka vetëm një rrugë, që për çështje të integritimit europian duhet të dëgjohet proporcionalisht zëri i opozitës, gjë që nuk ka ndodhur. Nëse vazhdohet me arrogancën që u deklarua pak më parë për ligjin e amnistisë: "do të kalojë", ky është shembulli i parë që i dhamë zonjës ambasadore, që, në fakt, është fytyra e vërtetë e politikës dhe kryesisht e maxhorancës. Amnisti fiskale nuk do të thotë thjesht dhe vetëm disa para më shumë, që vijnë në parajsën fiskale që quhet Shqipëri, por është diçka më shumë, është i gjithë potenciali kriminal që mund të importohet këtu.

Çfarë u themi ne shqiptarëve, shkelni ligjin, bëni korrupsion, merruni me krim këtu apo jashtë, se në Shqipëri ju pranojnë të sillni të gjithë këtë potencial kriminal? Çfarë u themi ne shqiptarëve, që, meqenëse po afrojnë zgjedhjet lokale, të shkallmojmë çdo lloj filtri për kontrollin financiar? Çfarë u themi ne shqiptarëve për korrupsionin?

Para një jave, njëri nga të akuzuarit doli nga burgu, pa iu futur kompetencës së sistemit gjyqësor në të drejtën e vet, ky është fakt, për një nga çështjet më flagrante korruptive.

Që ta mbyll, se ndoshta kjo është shija e parë që zonja ambasadore do të duhet të marrë, ky është realiteti. Ne nuk duhet të shohim sytë e ambasadores, por duhet të shikojmë sytë e njëri-tjetrit, nëse kemi maturinë dhe pjekurinë politike për të parë se cila është nevoja ulëritëse e shqiptarëve, jo ta gjejnë Europën duke shkuar atje, natën, por ta bëjnë këtu. Faleminderit!